

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË “BANKA CREDINS” SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e hene datë 30 dhjetor 2024 ora 11:00 në ambientet e “ BANKA CREDINS” SH.A., në adresën Rr. “Vaso Pasha” Nr. 8, Tiranë, do te zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të “BANKA CREDINS” SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Vendimmarrje e Aksionerëve të Bankës Credins lidhur me aksionet ende të panënshkruara të emetuara me Vendimin nr. 04/1, datë 08.08.2024 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë “Banka Credins” Sh.a.
2. Propozim per rritjen e kapitalit te Bankes Credins ne masën 10 milion Euro nëpërmjet emetimit te aksioneve te reja.
3. Parashikim mbi nevojat e Bankës Credins per kapital gjate vitit 2025.
4. Shprehje interesi dhe vendimmarrje lidhur me mundesine dhe proçeduren e konvertimit te aksioneve “me të drejtë vote” ne aksione “me përparësi pa të drejtë vote”.
5. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjevez të Investimeve Kolektive te zhvilluar gjate periudhes ne shtator 2024 me rend dite si me poshtë:
 1. Mbi miratimin e ndryshimit të strukturës aksionare, të shoqërisë “Credins invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, përfshirë dhe të drejtën e parablerjes nga Aksionarët ekzistues të shoqërisë.
 2. Mbi miratimin e ndryshimeve të Statutit të shoqërisë “Credins Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve.
 3. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
6. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjet e Asambleve të Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, per periudhen shtator – dhjetor 2024 me rend dite sa me poshtë:
 1. Mbi miratimin e raportit të vlerësuesit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund” Shoqëri Komandite SIK.
 2. Mbi miratimin e rritjes së kontributeve në shoqërinë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK.
 3. Mbi miratimin e Statutit të shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK.

4. Mbi miratimin e lidhjes dhe nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes dhe bashkëpunimit në ndërtim me shoqërinë Natura Resort sh.p.k. për pasuritë e paluajtshme në pronësinë e shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, me objekt zhvillimin dhe ndërtimin e pasurive në pronësi të shoqërisë.
 5. Mbi miratimin në parim të rritjes së kapitalit të shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK.
 6. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë Colliers Albania, me NIPT L321160211, në cilësinë e vlerësuesit të pasurive të paluajtshme, si dhe tekstin e kontratës që do të lidhet me shoqërinë Colliers Albania.
 7. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë "Venis - Audit & Financë" me NIPT L12005002L, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe tekstin e draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë "Venis - Audit & Financë".
 8. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
7. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, për periudhën shtator – dhjetor 2024 me rend dite sa me poshtë:
1. Mbi miratimin e raportit të vlerësuesit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK.
 2. Mbi miratimin e rritjes së kontributeve në shoqërinë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
 3. Mbi miratimin e Statutit të shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
 4. Mbi miratimin e lidhjes dhe nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes dhe bashkëpunimit në ndërtim me shoqërinë Natura Resort sh.p.k. për pasuritë e paluajtshme në pronësinë e shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, me objekt zhvillimin dhe ndërtimin e pasurive në pronësi të shoqërisë.
 5. Mbi miratimin e largimit nga detyra të Administratorit të shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
 6. Mbi miratimin e emërimit të administratorit të ri shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
 7. Mbi miratimin e ndryshimeve në nenin 13 të Statutit të shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK dhe tekstit të konsoliduar të tij.
 8. Mbi miratimin në parim të rritjes së kapitalit të shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
 9. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë Colliers Albania, me NIPT L321160211, në cilësinë e vlerësuesit të pasurive të paluajtshme, si dhe tekstin e kontratës që do të lidhet me shoqërinë Colliers Albania.
 10. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë "Venis - Audit & Financë" me NIPT L12005002L, në cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe tekstin e draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë "Venis - Audit & Financë".
 11. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
8. Ngarkohet Drejtoria të beje njoftimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane me 10.12.2024

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionerët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.